



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3017/2 Prot.

Tiranë, më 09.10.2023

V E N D I M

Nr. 62 , datë 09.10.2023

“PËR MIRATIMIN E KOSTOS SË STUDIMEVE NË PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MJEKËSI E PËRGJITHSHME”, QË OFROHET NGA FAKULTETI I MJEKËSISË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 3, pika 3 dhe 49; në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 51; në Vendimin e KM-së nr. 527, datë 07.09.2023 “Për caktimin e metodologjisë së kostos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi”, pika 6; në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 61, datë 02.10.2023 “Për përcaktimin e kostos së studimeve për programin e integruar të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në UMT”; në Vendimin Qarkullues të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nr. 5, datë 04.10.2023 “Për miratimin e propozimit të Administratorit të Fakultetit të Mjekësisë me nr. 2590 prot., datë 04.10.2023 “Kërkesë për Propozim”, në Relacionin e Grupit të Punës nr. 2693/7 prot., datë 04.10.2023 “Mbi një shtesë në Relacionin e Grupit të punës nr. 2693/3 prot., datë 27.09.2023 “Mbi analizën e kostos për programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme” në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”; në Vendimin Qarkullues të Rektoratit të UMT-së nr. 17, datë 05.10.2023 “Për miratimin e kostos së studimit të programit të integruar të studimit “Mjekësi e përgjithshme” që ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin të Mjekësisë, Tiranë”, si dhe në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik të UMT-së, nr. 109, datë 06.10.2023 për “Miratimin e kostos së studimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, që ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, në mbledhjen e datës 09.10.2023, Bordi i Administrimit të UMT-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë koston e studimeve të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, mbështetur në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik të UMT-së, nr. 109, datë 06.10.2023,¹ në tabelën e mëposhtme:

¹ Me Vendimin nr. 63, datë 11.10.2023 të Bordit të Administrimit të UMT-së, në pikën 1 të Vendimit nr. 62, datë 09.10.2023 është korrigjuar gabimi në shkrim i datës nga “16.10.2023” në “06.10.2023”.

	Të dhënat për Fakultetin e Mjekësisë	Të dhënat për programin e studimit "Mjekësi e Përgjithshme"
Pesha Specifike	100%	51.8%
Kosto direkte		
Fondi personeli	747,170,330	387,034,231
Shpenzime për bursa	83,700,000	76,400,000
Total kosto direkte	830,870,330	463,434,231
Kosto indirekte		
Shpenzime Kapitale 10% mbi fondin e pagave*	83,087,033	38,703,423
Shpenzime Operative 15% mbi fondin e pagave*	124,630,550	58,055,135
Total kosto indirekte	1,038,587,913	96,758,558
Total kosto (direkte + indirekte)	1,869,458,243	560,192,789
Numri i kuotave të certifikuara të studenteve MP viti akademik 23-24		2,250
Kosto për student		248,975

2. Vendimi i përcillet Rektorit dhe Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI
(nënshkrimi)
(vula e institucionit)

ANËTARË

MONIKA FIDA
(konfirmim on line)

VERA OSTRENI
(nënshkrimi)

ALBANA GJINOPULLI
(nënshkrimi)

ANIS THODHORJANI
(nënshkrimi)

ALTINA XHAFERI
(nënshkrimi)

ENDRIT YZEIRAJ
(nënshkrimi)

VENDIM QARKULLUES
Nr. 109, datë 06.10.2023

PËR

“MIRATIMIN E KOSTOS SË STUDIMIT TË PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MJEKËSI E PËRGJITHSHME”, QË OFROHET NGA FAKULTETI I MJEKËSISË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 dhe neni 37 dhe 38; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 07.09.2023 “Për caktimin e metodologjisë së kostos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi”; në Statutin e UMT-së, neni 5 dhe neni 25, 26 dhe 27; si dhe në Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, neni 17, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 61, datë 02.10.2023 “Për përcaktimin e kostos së studimeve për programin e integruar të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në UMT”; në Vendimin Qarkullues të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nr. 5, datë 04.10.2023 “Për miratimin e propozimit të Administratorit të Fakultetit të Mjekësisë me nr. 2590 prot., datë 04.10.2023 “Kërkesë për Propozim”, në Relacionin e Grupit të Punës nr. 2693/7 prot., datë 04.10.2023 “Mbi një shtesë në Relacionin e Grupit të punës nr. 2693/3 prot., datë 27.09.2023 “Mbi analizën e kostos për programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme” në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”; në Vendimin Qarkullues të Rektoratit të UMT-së me nr. 17, datë 05.10.2023 “Për miratimin e kostos së studimit të programit të integruar të studimit “Mjekësi e përgjithshme” që ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, Senati Akademik i UMT-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë koston e studimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, që ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë sipas tabelës më poshtë:

	Të dhënat për fakultetin	Të dhënat "Mjekësi e Përgjithshme"
Pesha Specifike	100%	51.8%
Kosto direkte		
Fondi personeli		

	747,170,330	387,034,231
Shpenzime për bursa	83,700,000	76,400,000
Total kosto direkte	830,870,330	463,434,231
Kosto indirekte		
Shpenzime Kapitale 10% mbi fondin e pagave*	83,087,033	38,703,423
Shpenzime Operative 15% mbi fondin e pagave*	124,630,550	58,055,135
Total kosto indirekte	1,038,587,913	96,758,558
Total kosto (direkte + indirekte)	1,869,458,243	560,192,789
Numri i kuotave të certifikuara të studenteve MP viti akademik 23-24		2,250
Kosto për student		248,975

* Shpenzimet e kapitale dhe operative janë marrë në vlerat minimale të parashikuara nga VKM nr. 527, datë 07.09.2023

Kosto totale/student = kosto direkte + kosto indirekte
= 205,971 lekë + 43,004 lekë
= **248,975 lekë;**

2. Vendimi i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
ARBEN GJATA

